

Sharrcem Faktet

LAB – Vizita Studimore në Shkollën Amerikane për Ferma ne Selanik



Në bazë të marrëveshjes që kemi me Shkollën Amerikane për Ferma në Selanik për ofrimin e trajnimeve të ndryshme me qëllim të ngritjes së vetëdijes për bujqësinë për fermerët e rinj nga Komuna e Hanit të Elezit, LAB (Laboratori për Aktivitete të Biznesit) - Sharrcem e ka ofruar një vizitë 5 ditore në objektet e SHAF.


Në këtë rast përpos ligjërimeve teorike ata kanë pasur mundësi që nga afër të shohin sipërfaqe të mëdha të tokës të mbjella me kultura të ndryshme bujqësore si dhe procesin nga mbjellja deri tek vendosja e produkteve në treg.

Ishte mjaftë interesante ta shohim fermerin i cili para pesë vitesh kishte filluar me kultivim



minimal të fidanëve të domateve, specave, organos dhe llojeve të ndryshme të luleve. Sa larg kanë arritur pas një pune të madhe dhe tani e tërë familja është transformuar në një kompani të madhe dobiprurëse e cila me cilësinë e lartë të produkteve të veta kishte qenë pjesë e të gjitha panairove kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në fermën e prodhimit të kërpudhave, prodhimi i kërpudhave të llojit "Perlë" ishte mundësi e mire të shihet përgatitja e koncentratit për mbjellje me qëllim të rritjes së prodhimit të kërpudhave, paketimit dhe përgatitjes për shitje. Kompania poashtu ka në dispozicion hapësirë të mjaftueshme për ftohje për magazinim dhe ruajtje më të mire të produkteve. Kjo ishte mundësi e mire për fermerët tone të LAB që ata ti kultivojnë produktet e njëjta në Han të Elezit.



Ishte e një interesi të veçantë për LAB të vizitohen vreshtat dhe prodhimi. Kjo ishte mundësi e mire sepse LAB planifikon që në të ardhmen të mbështes edhe familje të tjera në këtë fushë, në kultivimin e rrushit në Han të Elezit. Përpos eksportit të këtyre produkteve kjo kompani ka prodhuar edhe uthull dhe ka bërë konservimin e gjetheve të rrushit për përdorim në kuzhinë. Ia vlen të theksohet se të gjitha këtë produkte ishin organike dhe të një cilësie të standardeve të larta.



Fermerët ekzistues kishin mundësinë ta vizitojnë fermën e shpezëve ku janë njoftuar për procesin e prodhimit të Bio vezëve, Prof. Vergos ka shpjeguar se si çifti në vitin 2012 ishte në zyrën e tyre pa punë dhe kishin 4 fëmijë ata kërkuan nga Prof. Vergos që t’ju jap ndonjë ide për fillimin e çfarëdo biznesi me qëllim të gjenerimit të të hyrave dhe kujdesit për familje, ju është sugjeruar ta hapin fermën dhe ata e kanë ndjekur këshillën e tyre të jetësore. Ata tashmë janë shumë të kënaqur me rezultatet.

Në vazhden e këtyre aktiviteteve fermerët patën rastin ta vizitojnë edhe tregun e gjelbër të Selanikut me qëllim që të kenë ide të qartë për të ardhmen në mënyrë që reklamimi i produkteve të tyre bujqësore dhe vendosja e tyre në tregun e Hanit të Elezit dhe më gjerë në Kosovë, të jetë më e lehtë. Ata poashtu i kanë vizituar edhe shitoret të cilat merren me shitjen e farërave dhe fidanëve të ndryshme si dhe shitoret për shitjen e makinave të

ndryshme bujqësore.



Të gjithë pjesëmarrësit ishin të kënaqur me vizitën studimore.

SHARRCEM

a **TITAN** Group Company



Group Corporate Values



INTEGRITY



KNOW-HOW

VALUE TO CUSTOMER



DELIVERING RESULTS

CONTINUOUS SELF-IMPROVEMENT



CORPORATE SOCIAL RESPONSIBILITY